



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 14, paragrafi 1, lidhur me paragrafin 3, te Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, konform neneve 15, 29, pika 2 te Statutit të Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 24.10.2019 miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 JEPET PËLQIMI- për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10, (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës parcela si më poshtë:

1.2 Parcela, kadastrale, me numër **P-72116046-02785-79**, sipas certifikatës Nr.4774/2019, të datës 08.10.2019 me sipërfaqe prej; **39779m²** vendi i quajtur “**Shiroko**”, zona kadastrale Suharekë, me destinim tokë ndërtimore, pasurisë shoqërore në emër të Kuvendit Komunal e Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej; **200m²** ndahen për ndërtimin e lokalit afarist të karakterit të përkohshëm.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr-10/2019, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-016.72889
Më datë 24.10.2019



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI